



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Agjencia e Kosovës për Akreditim
Agencija Kosova za Akreditaciju
Kosovo Accreditation Agency



Ref.:968/25, Datë:01.08.2025

Në mbështetje të nenit 11 të Ligjit nr. 08/I-110 për Agjencinë e Kosovës për Akreditim (GZ.nr.13/29 qershor 2023, Prishtinë, nenit 7 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-037 (GZ, Nr.14/9 Shtator 2011), Ligjit për Procedurën e Përgjithshëm Administrative Nr.05/L-031 (GZ.Nr.20/12 Qershor 2016), Udhëzimi Administrativ (MASHTI) Ua 01B-03/2024 për vlerësimin e përshtatshmërisë së bartësve të programeve Rregullorja (AKA) Nr.04/2024 për Manualin e Akreditimit/Riakreditimit dhe Validimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe Programeve të Studimit në Nivelin Baqelor dhe Master, Rregulloren e Punës së Këshillit Shtetëror të Cilësisë, si dhe referuar procesverbalit të mbledhjes së 140 të mbajtur me datë 24.07.2025 Këshilli Shtetëror i Cilësisë, mori:

V E N D I M

- I.** Aprovohet kërkesa e Kolegjit RIT Kosovo (A.U.K) me Nr.643/25 datë 04.06.2025 për zgjatjen e periudhës së validimit të akreditimit edhe për një (1) vit akademik (nga 1 tetor 2025 - 30 shtator 2026) për programin e studimeve:
 - *Studime Profesionale, MSc 66 ECTS; (me specializim Parashikim Strategjik dhe Inovacion) (R).*
- II.** Zgjatja e validimit të akreditimit bëhet me kushtet dhe kriteret e njëjta të përcaktuara me vendimin e KShC-së Ref.:1323/22 datë 16.09.2022.
- III.** Institucioni i Arsimit të Lartë - Kolegji RIT Kosovo (A.U.K) mbanë përgjegjësi ligjore për çdo moszbatim apo tejkalim të vendimit KShC-së Ref.:1323/22 datë 16.09.2022 dhe të këtij vendimi.
- IV.** Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

A R S Y E T I M

Kolegji RIT Kosovo (A.U.K) ka parashtruar kërkesë pranë Agjencisë së Kosovës për Akreditim (AKA) Nr.643/25 datë 04.06.2025 për zgjatjen e periudhës së validimit të akreditimit edhe për një (1) vit akademik (nga 1 tetor 2025 - 30 shtator 2026) për programin e studimeve:

Studime Profesionale, MSc 66 ECTS; (me specializim Parashikim Strategjik dhe Inovacion) (R).

Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KSHC) në mbledhjen e 140-të, të mbajtur më datë 24.07.2025 ka shqyrtuar kërkesën dhe duke u bazuar në arsyeshmërinë e kërkesës, në të cilën Kolegji ka ofruar: dëshmi faktike dhe juridike me të cilat është akredituar/riakredituar programi në fjalë.

Kërkesa është bërë për vazhdimin e validimit të programit të studimit deri më 30 shtator 2027, bazuar në vendimin e mëparshëm të KShC-së Ref.:1323/22 datë 16.09.2022 të Agjencisë së Kosovës për Akreditim dhe vlerësimin e ATMAE (Association of Technology, Management, and Applied Engineering) e cila është e fokusuar kryesisht në SHBA.

Periodha e ri/akreditimit sipas ATMAE për programin në fjalë, ishte deri me 31.10.2026, si dëshmi kemi certifikatën e bashkangjitur për akreditimin e programit të lartshënuara.

Meqenëse vendimi për validim Ref.:1323/22 datë 16.09.2022 ishte lëshuar për periudhën 5 vjeçare, pra 1 vit më pak se sa akreditimi nga ATMAE, është bërë duke u bazuar në nenin 19 të UA 15/2018 për akreditimin e IAL-ve në Republikën e Kosovës e cila thotë "Kohëzgjatja e akreditimit programeve është jo më shumë se pesë (5) vjet", dhe tani edhe me Ligjin nr. 08/L-110 për Agjencinë e Kosovës për Akreditim, përkatësisht me nenin 35, paragrafin 2. "Kohëzgjatja e riakreditimit të programit është tre (3) ose pesë (5) vjet".

KShC tani ka marr parasysh vlerësimin e ATMAE dhe ka vendosur që të zgjatet edhe për një (1) vit validimi i akreditimit për këtë program.

Këshilli Shtetëror i Cilësisë, në mbledhjen e 140 të mbajtur më datë 24.07.2025, ka shqyrtuar kërkesën dhe dokumentacionin relevant të Kolegjit RIT Kosovo (A.U.K) dhe duke u bazuar në kërkesën, dispozitat ligjore të lartcekura dhe kompetencat, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të paraqet ankesë në Komisionin e ankesave, në afatin prej tridhjetë (30) ditësh nga dita kur pala është njoftuar për aktin administrativ. Ankesa adresohet përmes organit publik që ka nxjerrë aktin.


Prof. Ass. Dr. Hasnija Ilazi
Kryetare e Këshillit Shtetëror të Cilësisë



Vendimi iu dërgohet:

- Kolegji RIT Kosovo (A.U.K);
- MASHTI;
- Arkivit të AKA-së.